



VENDIMI I PAPRANUESHMËRISË

Data e miratimit: 29 shkurt 2016

Lënda nr. 2015-08

Afrim Berisha

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 29 shkurt 2016, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Paul LANDERS, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 17 qershor 2015.

II. FAKTET

2. Faktet e ankesës të parashtuara nga ankuesi mund të përmbliidhen si në vijim:

3. Me 18 qershor 2000, në ora 10.00, ankuesi ishte duke vozitur makinën e tij për në punë, në Hotel Grand në Prishtinë, kur u ndalua afër hotelit nga Policia e Kosovës, të cilët i thanë se nuk i lejohej të shkoj më tutje pasi që rruga ishte e bllokuar.
4. Ankuesi deklaron se e ka njoftuar Policin e Kosovës se ai punon në Hotelin Grand dhe se ai ka një vend parkimi brenda garazhës së hotelit. Pastaj Policia e lejoi të voziste drejt vendit të tij të punës. Ankuesi deklaron se arsyeja përse rruga ishte e bllokuar ishte se dyshohej për një bombë në hyrjen kryesore të Hotelit Grand.
5. Ankuesi deklaron se në ora 11.00, KFOR-i filloi të kontrolloj veturat jashtë hotelit me robot, por nuk gjeti asgjë të dyshimtë. Rreth orës 13.00, KFOR filloi të kontrolloj veturat në anën e kundërt të parkingut, aty ku vetura e tij ishte e parkuar. Nga ora 13.00 deri në 15.00, KFOR-i përdori robotin për të kontrolluar veturën e ankuesit.
6. Ankuesi deklaron se KFOR-i vendosi dinamit në pjesën e pasme të veturës së tij dhe e kreu një eksplozim të kontrolluar që rezultoi me dëmtimin e pjesës së pasme të veturës së tij. Pastaj ata filluan t'i prenin ulëset e veturës me thika dhe e heqën gjithë tapicerinë, përfshirë edhe tapicerinë e dyerve dhe të tavanit të veturës. Ankuesi deklaron se disa herë ishte penguar nga KFOR-i që t'i afrohet veturës.
7. Disa ditë më vonë, ankuesi shkoj në kompaninë e tij të sigurimit për të dorëzuar një kërkesë për dëmet e shkaktuara në automjetin e tij. Kompania e sigurimeve fotografoj automjetin dhe vlerësoj dëmin mirëpo e njoftoj ankuesin se ai duhet të shkojë tek ata që e kanë shkaktuar dëmin në mënyrë që të merrte kompensim për humbjen dhe dëmin e shkaktuar në automjetin e tij.
8. Ankuesi shkoj tek përfaqësues të ndryshëm të KFOR-it dhe UNMIK-ut, ndërsa tek përfaqësuesi i KFOR-it ai dorëzoi një CD, ku ishte një incizim rreth dëmit në automjetin e tij. Ankuesi deklaron se KFOR-i e informoi atë se ata do të paguanin dëmin dhe do ta kontaktonin atë me telefon, por deri në datën e dorëzimit të ankesës së tij në PShDNj, askush nuk e ka kontaktuar atë.
9. Ankuesi thekson se ai ishte përpjekur po ashtu në tre raste, një herë në vitin 2014 dhe dy herë në vitin 2015, që të kontaktonte EULEX-in dhe të kërkonte nga ta që të merreshin me rastin e tij, mirëpo në secilin rast Sigurimi i EULEX-it në selinë e Misionit i kishte mohuar atij çdo kontakt me personelin e EULEX-it.

III. ANKESA

10. Ankuesi pohon se e drejta e tij për qasje në drejtësi i është mohuar dhe se të drejtat e tij ekonomike janë shkelur nga ana e KFOR-it dhe UNMIK-ut. Ai gjithashtu pohon se atij i ishte mohua çdo kontakt me stafin e EULEX-it në tri raste nga ana e Sigurimit të EULEX-it në selinë e Misionit.

IV. VLERËSIMI I PANELIT

11. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
12. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së Punës.
13. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, të Rregullores së Punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat lidhur me shkeljet e pretenduara të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave.
14. Paneli thekson se ankesa ka origjinën nga një incident që ka ndodhur në Prishtinë në qershor të vitit 2000, nën administrimin e UNMIK-ut dhe ka të bëjë me veprimet dhe/ose mosveprimet e KFOR-it dhe policisë së UNMIK-ut. Duke marrë parasysh rregullën 25 të rregullores së punës, e cila e kufizon mandatin e Panelit në ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera nga ana e EULEX-it, Paneli vëren se nuk ka juridiksion për të shqyrtuar veprimet ose mosveprimet nga KFOR-i dhe/ose të UNMIK-ut (Shih Thaqi kundër EULEX-it, 14 shtator 2011, nr. 2010-02). Për më tepër, sipas rregullës 25, paragrafi 2 të rregullores së punës, Paneli shqyrton vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur pas datës 9 dhjetor 2008, në Kosovë, datë në të cilën EULEX-i u bë operacional.
15. Përveç kësaj, Paneli nuk duhet të vendosë nëse, në rrethanat e tanishme, EULEX-i do të jetë kompetent për të hetuar një vepër të dyshuar penale që del nga ky incident. Paneli konstaton se në të vërtetë nuk ka informata të cilat ankuesi mund t'i tregojë e që do të sugjeronin se ishte kryer ndonjë vepër penale në këtë rast.
16. Është e paqartë nga ankesa se si ankuesi sugjeron që EULEX-i mund të mbahet përgjegjës për shkeljen e të drejtave të tij të njeriut. Fakti që atij supozohet se i është mohuar qasja në selinë e EULEX-it në vetvete nuk përbën shkelje të të drejtave të tij të njeriut. Selia e EULEX-it nuk është ndërtesë publike dhe qytetarët nuk kanë të drejtë të garantuar themelore të kenë qasje në të. Nuk është argumentuar apo treguar nga ankuesi se ai ka bërë ndonjë ankesë zyrtare në EULEX. Më tej Paneli thekson se ankuesi kishte në dispozicion shumë rrugë të tjera, përmes së cilave ai mund të kontaktonte EULEX-in për ankesën e tij. Në të vërtetë ende është e hapur mundësia për ankuesin që të parashtrij ankesë me shkrim në EULEX në lidhje me këtë çështje.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

Deklaron se nuk ka kompetencë për të shqyrtuar ankesën, pasi ajo bie jashtë juridiksionit të tij sipas nenit 29 (d) të rregullores së punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

Joanna Marszałik
Zyrtare ligjore

Magda Mierzewska
Kryesuese